



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:031799

Datë: 06.01.2023

Numri i dokumentit: 03833910

C.nr.100/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. D. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmit, vlera e kontestit 3,100.00 €uro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **06.01.2023** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditëses S. D. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësja S. D. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.100/2022 të datës 07.04.2022 e ka ftuar paditësen që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguaj taksën gjyqësore për padi, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditëses me datën 27.04.2022 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 parg. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësja nuk e ka bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të saj nga pagesa e së njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 parag. 5 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr.100/2022, me datë 06.01.2023.**

**Bashkëpunëtor profesional
Samir Morina**

**G j y q t a r i
Besmir Juniku**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.